



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRIKUM ZA OKOLNU OKREDINU, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Unit	SP-02
Nr. i Faqeve In Strani a No. Pages	4
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	77/19-2/25
Datë Datum Date	22.05.25
PRISHTINË / A	
Na. I	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	19.05.2025
REFERENC-Ë:	24/7719/762/MMPHI
PËR/ZA/TO:	Spitali i Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa", Prizren
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga ana e Juaj me nr.prot.: 24/7719/762/DMMU, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për Refuzimin e kërkesës së Spitali i Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa", Prizren për Implantin për Trajtimin e Mbetjeve Spitalore në Spitalin e Prizrenit.

Me respekt,

Faqe 1 nga 4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958/23 datë 13.07.2023), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Refuzimin e kërkesës së Spitalit të Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa", Prizren në ngastrën me nr. 08442-0-315-0, zonën kadastrale Prizren, Komuna e Prizrenit.

Faqe 2 nga 4

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave "Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://ëëë.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

Ar sy e t i m

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Raportit të VNM-së dhe dokumentacionit përcjellës të Spitalit të Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa", Prizren për Implantin për Trajtimin e Mbetjeve Spitalore Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për VNM ka konstatuar se lënda e dorëzuar nuk është e kompletuar dhe nga aplikuesi ka kërkuar ta bëjë plotësimin/ndryshimin me dokumentacionin shtesë si në vijim:

- Aplikimi duhet të bëhet në emër të Spitalit të Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa", Prizren e jo nga kompani tjera;
- Raporti i VNM-së duhet të hartohet sipas legjislacionit në fuqi;
- Raporti duhet të nënshkruhet nga hartuesi dhe aplikuesi;
- Kompania "Eng-Idea" Sh.p.k. nuk është e licencuar për hartimin e Raporteve të VNM-së dhe duhet të hiqet nga Raporti i dorëzuar;
- Mungon Certifikata e Biznesit e Spitalit të Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa".

Me datën 14.02.2025 aplikuesi ka sjellë dokumentacionin e kërkuar dhe me datën 26.02.2025 aplikuesit ju është dërguar njoftimi për organizimin e debatit publik.

Në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, neni 16, me datën 07.05.2025 është mbajtur debati publik. Gjat mbajtjes së debatit publik për shkak të mosfunksionimit të linkut për kyqje në debat përfaqësuesi i MMPHI-së nuk ka pasur mundësi kyqjeje në debat, me çka është shkelur procedura e përcaktuar me ligj dhe për këtë Komisioni për VNM ka marrë vendimin që Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së ti propozoj që ta refuzoj kërkesën e Spitalit të Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa", Prizren për pajisje me Pëlqim Mjedisor.

Bazuar në të lartcekuat, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nxjerr Vendim për **Refuzimin** e kërkesës për Pëlqimi Mjedisor Spitalit të Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa", Prizren.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimet e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 24/7719/1- ZSP/ /25 datë: 19.05.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. *Parashtruesit të kërkesës*
2. *Komisionit për VNM*
3. *Inspektoratit*
4. *Komunes se Prizrenit*
5. *Kabinetit të Ministrit*
6. *Divizioni për komunikim me publikun*
7. *Arkivit të MMPHI*



Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm
të MMPHI